



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:211062

Datë: 07.02.2020

Numri i dokumentit: 00817619

P.nr.1018/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Rrahman Beqiri, me procesmbajtëse Selvije Kostërci, në lëndën penale ndaj të akuzuarit: A.S nga Mitrovica, për shkak të veprës penale: Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.8 lidhur me par. 6 e 1 të Kodit nr. 04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës (tutje: KPRK), sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1558/2019, të datës 24.09.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 21.01.2020 në prezencën e Prokurorit të Shtetit Jelena Marjanovic, të dëmtuarit M.D dhe të pandehurit A.S, me datë 22.01.2020 e shpalli publikisht, ndërsa me datë 07.02.2020 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

A.S, nga i ati D., e ëma S., e vajzërisë P., i lindur me datë ... në Mitrovicë, ku edhe tani jeton në rr. "...", nr. ..., i pa punë, i pa martuar, me nr.personal ..., ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, serb, shtetas i Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse,

Më datë 23.03.2019, rreth orës 10:00, në rr."Magjistrale Mitrovicë – Leposaviq, tek vendi Srbovc – Zveçan, duke e drejtuar veturën e tipit "Hundai – Senta Fe" me targa ..., duke mos ia përshtatur shpejtësinë kushteve dhe gjendjes së rrugëve, i ka shkelur dispozitat e nenin 53 të Ligjit për rregullat e trafikut rrugor meqë e ka rrezikuar trafikun publik dhe jetën e njerzëve, edhe pse ka qenë i vetdijshëm se me një veprim të tillë mund të shkaktojë pasojat të ndaluara por lehtësisht ka menduar se nuk do të vijë deri te pasojat apo mund ti shmang ato dhe ka ardhur deri te pasojat kur më parë në vijë të plotë e ka tejkalluar veturën e tipit "Golf 4" me targa ..., të cilën e ngiste S.V, pastaj për shkak të shpejtësisë së papërshtatshme është munduar t'i shmanget kamionit të tipit "Kmbi Ford", transit, me targa ..., me pronar L.R, pas së cilës e ka humbur kontrollin në veturë dhe e ka goditur pjesën anësore rrugës, ka kaluar në anën e kundërt të rrugës e pastaj vetuar është rrokullisur në kulm për shkak të së cilës i dëmtuari, bashkudhëtari në veturën e tij M.D ka marrë lëndime të rënda truporë në formë të thyerjes së brinjëve të krahrorit.

Me këtë ka kryer veprën penale: Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.8 lidhur me par.6 e 1 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 23, 41, 42, 43, 46, 47, 73 e 378 të KPRK-së, dhe nenit 365, 450, 463 të KPP-së, e:

G J Y K O N

1. Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nga plotëfuqishmëria e këtij aktgjykimi.
2. Obligohet i pandehuri, që t'i paguajë shpenzimet e procedurës gjyqësore sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, dhe atë për ekspertizën e komunikacionit shumë prej 40.88€, për ekspertizën mjeko-ligjore shumë prej 20€, në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumë prej 20€, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 30€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
3. Për realizimin e kërkesës pasurore – juridike, pala i dëmtuari M.D, udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

Gjykata, në bazë të nenit 47 të KPRK-së dhe me pëlqimin e të akuzuarit, dënimin me burg në kohëzgjatje prej 5 muajve ia zëvendëson me dënim me gjobë, ashtu që:

4. Obligohet i akuzuarit që të paguajë gjobën në shumë prej 650€ (gjashqindë e pesëdhjet euro), të cilën gjobë është i obliguar ta paguajnë në afat prej tre (3) muajve nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, gjykata do të veprojë në bazë të nenit 46 të KPRK-së, ashtu që dënimin me gjobë mund t'ia zëvendësoj me dënim me burg, ku një ditë burgim do të llogaritet me 20 (njëzet) euro gjobë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur Aktakuzën PP.II.nr.1558/2019, të datës 24.09.2019, kundër të akuzuarit A.S nga Mitrovica, për shkak të veprës penale: Rrezikimi i trafikut publik neni 378 par.8 lidhur me par.6 e 1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar ashtu që në këtë seancë i pandehuri e ka pranuar fajësinë në tërësi sipas aktakuzës, duke theksuar se e pranoi fajësinë për këtë veprë penale, ka ndodhur nga pakujdesia, ne kemi qenë në një veturë ku edhe unë jamë lënduar, ne jemi shokë në mes vete, edhe ashtu me raporte tona janë të rregulluara, andaj e lus Gjykatën që të merrë parasysh rrethanat tona lehtësuese dhe rrethana personale.

Prokurori, lidhur me pranimin e fajësisë ka deklaruar, në bazë të nenit 248 konsideroj se janë përmbushur për pranimin e fajësisë, pranimi është bërë në mënyrë vullnetare, pa presion, pranimi mbështetet në provat materiale që gjendet në shkresat e lëndës, prandaj i propozoj Gjykatës që ta pranoi pranimin e fajësisë dhe këtë pranimi i fajësisë ta merr parasysh di rrethanë lehtësuese me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit.

I dëmtuari M.D ka deklaruar se pajtohem që t'i pranohet fajësia, ne kemi qenë shok dhe vazhdojmë të mbesim shokë, tani nuk kam probleme shëndetësore dhe në përgjithësi gjendja ime shëndetësore është e mirë, e kam realizuar kompensimin dhe i propozoj gjykatës një dënim sa më të butë.

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i pandehuri, e në mbështetje të nenit 248 të KPP-ës, në këtë drejtim vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të pandehurin. Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykate si: Raporti i policit, të datës 23.03.2019; Fletëlëshimi me epikrizë me nr.728, e datës 25.03.2019; Raporti mjeksorë nga dr. B.C për të pandehurin, datës 23.03.2019; Deklarata e të pandehurit A.S e dhënë në polici, e datës 28.03.2019; Deklarata e të dëmtuarit M.D e dhënë në polici; Deklarata e dëshmitarit L.R e dhënë në polici, e datës 23.03.2019; Deklarata e dëshmitarit S.V e dhënë në polici, e datës 23.03.2019; Raporti i Ekspertizës së komunikacionit ing. F.T, datës 18.06.2019; Akt ekspertimi mjeko-ligjor i Dr. N.U, datë 14.06.2019; dhe Fotoalbumi. Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë e tyre dhe pranimit të fajësisë, konsiderojmë se për tej çdo dyshimi është vërtetuar se i pandehuri, ka kryer veprën penale që i vihen në barrë.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare, se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, duke iu tërhequr vërejtja të pandehurit se pas pranimit të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, por vetëm sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë së të pandehurit dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale: Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.8 lidhur me par. 6 e 1 të KPRK, e për të cilën vepër penale është paraparë dënimi me burgim prej 6 (gjashtë) muaj deri në 5 (pesë) vjet.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 73 të KPRK-ës. Si rrethana rënduese ka gjetur intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, e që kjo vepër penale ka qëllim të mbrojtë jetën dhe trupin e individit, gjë që në rastin konkret është rrezikuar shëndeti i të dëmturit, ndërsa rrethana tjera rënduese nuk ka gjetur.

Ndërsa, si rrethanë lehtësuese gjykata e ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale në të gjitha fazat e procedurës, që nga fillimi i procedurës penale, faktin se i njëjti ka shprehë keqardhje dhe është penduar për ndodhjen e rastit, faktin se për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin pasi që nga shkresat e lëndës rezulton se nuk dyshohet për ndonjë vepër tjetër penale, personalitetin e tij, rrethanat personale të pandehurit duke qenë se është i ri dhe i pa punës, faktin se gjendja shëndetësore e dëmtuarit është e mirë dhe se raportet mes tyre kanë qenë dhe mbeten shoqërore si dhe faktin se tashmë i njëjti e ka realizuar kompensimin, këto rrethana sipas deklaramit të të dëmtuarit.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se, shqiptimi i dënimit me burgim, i cili me pëlqimin e të pandehurit është zëvendësuar në dënim me gjobë, i cili është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Po ashtu, gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 par 1 të KPRK-së, që ti parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Po ashtu, ky dënim do të shërbejë si masë preventive që në të ardhmen i pandehurti t'i përmabhet sjelljeve në komunikacion.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par. 2 pika 2.1 dhe 2.6 dhe nenit 453 par.1 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet për ekspertë dhe të paushallit gjyqësor. Ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 39 par. 3 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 365, 450, 453 të KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.1018/2019, dt.07.02.2020
2019:211062, dt. 07.02.2020

Procesmbajtësja:
Selvije Kostërci

Gjyqtari

Rrahman BEQIRI

Këshillë juridike: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjyaktës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.